



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**VENDIM**

**Nr. 89/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 67/2021  
“PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME  
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në pikën I të vendimit nr. 67/2021 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deputeti Eduard Ndreca caktohet zëvendëskryetar.

II. Në Komisionin për Politikën e Jashtme deputeti Blendi Klosi caktohet zëvendëskryetar.

III. Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat deputetja Blerina Gjylameti caktohet zëvendëskryetare, ndërsa deputetja Enslemvera Zake caktohet sekretare.

IV. Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare deputeti Xhemal Qefalia caktohet zëvendëskryetar, ndërsa deputetja Antoneta Dhima caktohet sekretare.

V. Në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin deputeti Fadil Nasufi caktohet zëvendëskryetar.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R E**

**Lindita NIKOLLA**

Miraturar në datën 16.12.2021